

Emertimi dhe Forma ligjore:

“Isobar Construction” sh.p.k

NIPT –i:

L12210036D

Adresa e Selise:

Tirane

Data e krijimit:

10.10.2011

Veprimtaria Kryesore:

Ndertim – Projektim, Rikonstruksione

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr 2
dhe Ligjit Nr. 9228, date 29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”)

VITI 2017

Pasqyrat Financiare jane individuale

Pasqyrat Financiare jane te shprehura ne Lek

Pasqyrat Financiare nuk jane te rumbullakosura

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare nga 01.01.2017-31.12.2017

Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare 15.02.2018

Pasqyra e Pozicionit financiar

AKTIVE	Shenime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Aktivitet monetare	4	181,438	110,058
Investime		-	-
Të drejta të arkëtueshme		-	-
<i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>		30,854,778	37,582,151
<i>Tvsh kreditore</i>		17,254,182	12,073,531
<i>Tatim fitimi I mbipaguar</i>		810,898	30
<i>Te tjera</i>		-	-
Totali I te drejtave te arketueshme	5	48,919,858	49,655,712
Inventarët		-	-
<i>Lende e pare dhe materiale</i>		3,105,125	7,887,167
<i>Parapagime per inventar</i>		-	-
Totali I inventarit	6	3,105,125	7,887,167
Shpenzime të shtyra	7	3,980,788	2,302,613
Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara		-	-
Totali I aktiveve afatshkurtra		56,187,208	59,955,551
Aktive financiare		-	-
Aktivitet materiale		-	-
<i>Mjete transporti</i>		16,967,116	18,690,058
<i>Te tjera pajisje</i>		2,100,279	2,579,188
<i>Pajisje zyre</i>		2,010,920	1,526,724
Shuma e aktiveve materiale	8	21,078,315	22,795,971
Aktivitet biologjike		-	-
Aktive jo materiale:		-	-
Aktive tatimore të shtyra		-	-
Kapitali i nënshkruar i papaguar		-	-
Totali I aktiveve afatgjata		21,078,315	22,795,971
Total Aktive		77,265,523	82,751,521

Administratori

ALBAN TARELLI
Alban Tarelli



Hartuesi i pasqyrave

Anita Pulaj
Anita Pulaj

Pasqyra e Pozicionit financiar

<u>PASIV</u>	<u>Shenime</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Detyrime afatshkurtra:			
<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>		30,406,739	8,903,081
<i>Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>		2,509,081	29,637,587
<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore</i>		359,061	272,718
<i>Te pagueshme te tjera</i>			7,865,000
<i>Te pagueshme ndaj institucioneve te kredise</i>		-	-
Shuma e detyrimeve afatshkurtra	9	33,274,880	46,678,385
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	-
Të ardhura të shtyra		-	-
Provizione		-	-
Total detyrime afatshkurtra		33,274,880	46,678,385
Detyrime afatgjata:			
<i>Detyrime ndaj institucioneve te kredise</i>		3,126,838	3,824,839
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	-
Të ardhura të shtyra		-	-
Provizione		-	-
Detyrime tatimore të shtyra		-	-
Total detyrime afatgjata	10	3,126,838	3,824,839
Total detyrime		36,401,718	50,503,224
Kapitali dhe Rezervat		-	-
Kapitali i Nënshkruar		100,000	100,000
Rezerva te tjera		32,148,297	20,603,823
Fitim / Humbja e Vitit		8,615,508	11,544,474
Total kapitali aksionar	11	40,863,805	32,248,297
Totali I kapitalit dhe I detyrimeve		77,265,523	82,751,521

Administratori

ALBAN TARELLI

Alban Tarelli



Hartuesi i pasqyrave

Anita Pulaj

<u>Pasqyra e performances</u>	<u>Shenime</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	12	105,404,254	91,827,951
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit			77,800
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	13	(62,352,390)	(56,500,864)
<i>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</i>		(48,274,522)	(43,985,870)
<i>Të tjera shpenzime</i>		(14,077,868)	(12,514,994)
Shpenzime të personelit	14	(17,580,091)	(13,593,260)
<i>Paga dhe shpërblime</i>		(15,065,877)	(11,652,612)
<i>Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>		(2,514,214)	(1,940,648)
Zhvlërësimi i aktiveve afatgjata materiale		-	(71,296)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	15	(4,676,164)	(2,340,421)
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	16	(9,891,045)	(15,550,373)
Të ardhura të tjera	17	33,550	5,833,951
Zhvlërësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare		-	-
Shpenzime financiare	18	(696,908)	3,919,204
<i>Shpenzime per interesa</i>		(268,148)	(102,791)
<i>Shpenzime të tjera financiare</i>			-
<i>Fitime/humbje nga kurset e kembimit</i>		168,022	4,037,962
<i>Te ardhura (gjoba te arketuara)</i>			-
<i>Gjoha dhe interesa</i>		(596,781)	(15,967)
Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet		-	-
Fitimi/Humbja para tatimit	19	10,241,206	13,602,692
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	19	(1,625,698)	(2,058,218)
<i>Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin</i>		(1,625,698)	(2,058,218)
Fitimi/Humbja e vitit	19	8,615,508	11,544,474
Te ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		8,615,508	11,544,474

Administratori

ALBAN TARELLI
Alban Tarelli



Hartuesi i pasqyrave

Anita Pulaj
Anita Pulaj

Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare	Shenime	(metoda indirekte)	
		31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		-	-
<i>Fitim / Humbja e vitit</i>		10,241,206	13,602,692
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>		4,676,164	2,340,421
<i>Vlera kontabel e aktiveve te shitura</i>		-	71,296
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		(1,678,175)	(2,302,613)
<i>Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera</i>		1,600,022	21,934,081
<i>Rënie/(rritje) në inventarë</i>		4,782,042	(7,887,167)
<i>Kritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme</i>		(13,403,505)	(11,703,536)
<i>Kritje/(rënie) në detyrime për punonjësit</i>			
<i>Tatim fitimi I paguar</i>		(2,489,866)	(2,058,248)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		3,727,889	13,996,925
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		-	-
<i>Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>		(2,958,507)	(17,878,399)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		(2,958,507)	(17,878,399)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		(698,002)	3,824,839
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		(698,002)	3,824,839
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare		71,380	(56,634)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar		110,058	166,692
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor		181,438	110,058

Administratori

ALBAN TARELLI



Hartuesi i pasqyrave

Anita Pulaj

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

	Kapitali I regjistruar	Rezerva te tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	100,000	7,420,003	13,183,820	20,703,823
Effekti i ndryshimeve në politikat kontabël				
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:				
Fitimi / Humbja e vitit			11,544,474	11,544,474
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:				
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:				-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:		13,183,820	(13,183,820)	-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike				-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2016	100,000	20,603,823	11,544,474	32,248,297
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:				-
Fitimi / Humbja e vitit			8,615,508	8,615,508
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:				-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:				-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:		11,544,474	(11,544,474)	-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike				-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	100,000	32,148,297	8,615,508	40,863,805

Administratori

Alban Tarelli
 Alban Tarelli



Hartuesi i pasqyrave

Anita Pulaj
 Anita Pulaj

SHENIMET SHPJEGUESE**1. Informacion i përgjithshëm**

Shoqëria « **Isobar Construction** » shpk është regjistruar pranë Regjistrimit Tregtar me datë 10.10.2011, me ortak dhe administrator të vetëm Z. Alban Tarelli. Kapitali i shoqërisë është 100,000 leke dhe kuotat e tij zotërohen 100% nga ortaku I vetëm.

Organizimi dhe funksionimi i saj rregullohet sipas ligjit Nr.9901 datë 14/04/2008 "*Per Tregtaret dhe shoqëritë tregëtare*" statutit të saj dhe legjisllacionit shqiptar në fuqi.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*".

Në bazë të urdhrimit nr.64 datë 22.7.2014 "*Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre*", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvec rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2017	2016
Euro/LEK	132.95	135.23
USD/ LEK	111.10	128.17

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e

parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

- Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

- Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

- Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

- Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

- Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare

vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivist me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyren	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Të Tjera	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe

detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13 Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Bilanci Kontabel, aktivet

4. Aktivet monetare

Aktivet monetare janë në shumën 181,438 leke, të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

Nr	Likujditete	Viti 2017	Viti 2016
1	Depozita në banke	162,398	107,133
2	Para në arke	19,040	2,925
	Totali	<u>181,438</u>	<u>110,058</u>

Depozitat në banke në monedhe të huaja janë të konvertuara me kursin e datës 31.12.2017, diferencat nga kursi i kembimit janë të pasqyruara në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

5. Te drejta te arketueshme

Paraqitet shuma e kerkesave te arketueshme prej 48,919,858 leke deri me 31.12.2017, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Klient per shitje e sherbime	30,854,778	37,582,151
2	Tvsh	17,254,182	12,073,531
3	Tatim fitimi	810,898	30
	Totali	<u>48,919,858</u>	<u>49,655,712</u>

6. Inventarët

Ne kete post paraqitet me 31.12.2017 inventari i materialeve ne shumen 3,105,125 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Materiale ndertimi	3,105,125	7,887,167
	Totali	<u>3,105,125</u>	<u>7,887,167</u>

Gjendja e materialeve eshte vleresuar me koston e blerjes. Gjate vitit 2017 nuk eshte ndryshuar menyra e mbajtjes se inventarit e cila vazhdon te jete me kosto mesatare.

7. Shpenzime të shtyra

Ne kete post paraqitet me 31.12.2017 shpenzime te cilat i perkasin periudhave te ardhshme ne shumen 3,980,788 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Shpenzime te shtyra	3,980,788	2,302,613
	Totali	<u>3,980,788</u>	<u>2,302,613</u>

8. Aktive materiale

Aktivet afat gjata materiale jane te paraqitura me koston e blerjes minus amortizimin e vitit. Vlera kontabel e tyre eshte 21,078,315 leke, sipas tabelës se meposhtme :

Emertimi	Mjete transporti	Makineri e pajisje	Te tjera ne shfrytezim	Totali
Aktive afat gjata materiale				
Gjendja me 31.12.2016	23,018,284	4,072,723	2,258,362	29,349,368
Shtesat per 2017	2,069,469	45,217	843,820	2,958,506
Paksimet per 2017				-
Gjendja me 31.12.2017	<u>25,087,753</u>	<u>4,117,940</u>	<u>3,102,182</u>	<u>32,307,875</u>
Amortizimi I AQT-ve				
Gjendja me 31.12.2016	4,328,226	1,493,535	731,638	6,553,398
Shtesat per 2017	3,792,412	524,128	359,625	4,676,164
Paksimet per 2017				-
Gjendja me 31.12.2017	<u>8,120,637</u>	<u>2,017,662</u>	<u>1,091,263</u>	<u>11,229,562</u>
Vlera neto 31.12.2017	<u>16,967,116</u>	<u>2,100,279</u>	<u>2,010,920</u>	<u>21,078,315</u>

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston (SKK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e hyrjes eshte bere me kosto dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus zhvleresimin e akumuluar dhe ndonje humbje nga renia e vleres. Drejtimi nuk ka llogaritur renie te vleres per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016.

Bilanci kontabel, pasivet**9. Detyrime afatshkurtra**

Paraqiten detyrimet afatshkurtra te shoqerise me 31.12.2017 ne shumen 33,274,880 leke.

Nr	Detyrimet afatshkurtra	Viti 2017	Viti 2016
1	Detyrime per furnitore	30,406,739	8,903,081
2	Detyrime per paga e dieta	2,509,081	29,637,587
3	Detyrime tatimore	359,061	272,718
4	Te pagueshme te tjera	-	7,865,000
	Totali I detyrimeve	<u>33,274,880</u>	<u>46,678,385</u>

9.1 Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit

Paraqitet gjendja e palikujduar e furnitoreve me 31.12.2017 ne shumen 30,406,739 leke. Vlerat e tyre ne monedha te huaja jane konvertuar me kursin e dates 31.12.2017 te Bankes se Shqiperise dhe diferencat jane kontabilizuar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve sipas SKK-ve.

9.2 Te pagueshme ndaj punonjesve

Paraqitet detyrimi qe shoqeria ndaj punonjesve per paga te palikujduara deri me 31.12.2017 ne shumen 2,509,081 leke.

9.3 Të pagueshme për detyrimet tatimore

Jane pasqyruar detyrimet e shoqerise ndaj shtetit jane ne shumen 359,061 leke si me poshte:

Nr	Detyrimet tatimore	Viti 2017	Viti 2016
1	Sigurime shoqerore dhe shendetsore	337,516	251,173
2	Tatimi mbi te ardhurat personale	14,300	14,300
3	Tatim ne burim	7,245	7,245
	Totali I detyrimeve	<u>359,061</u>	<u>272,718</u>

10. Detyrime Afatgjata

Ne kete post paraqitet detyrimi i shoqerise per qera financiare me 31.12.2017, ne shumen 3,126,838 leke.

Nr	Detyrimet afatgjata	Viti 2017	Viti 2016
1	Qera financiare	3,126,838	3,824,839
	Totali I detyrimeve	<u>3,126,838</u>	<u>3,824,839</u>

11. Kapitali

Gjate vitit 2017 jane shtuar kapitalet e veta me fitimin e vitit ne shumen 8,615,508 leke. Totali i kapitaleve te veta te shoqerise eshte 40,863,805 leke.

Nr	Emertimi	Kapitali I nenshkruar	Rezerva te tjera	Fitimi I vitit	Totali
1	Gjendja me 31.12.2016	100,000	20,603,823	11,544,474	32,248,297
2	Shtesat per 2017	-	11,544,474	8,615,508	20,159,982
3	Pakesimet per 2017	-	-	(11,544,474)	(11,544,474)
	Gjendja me 31.12.2017	<u>100,000</u>	<u>32,148,297</u>	<u>8,615,508</u>	<u>40,863,805</u>

Pasqyra e performances**12. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit**

Paraqiten te ardhurat e realizuara nga aktiviteti per vitin ushtrimor 2017 ne shumen 105,404,254 leke.

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Te ardhura nga aktiviteti	105,404,254	91,827,951
2	Te ardhura nga shitja e aktiveve	-	77,800
	Totali I te ardhurave	<u>105,404,254</u>	<u>91,905,751</u>

Sqarim per raportimin e shitjeve ne rubriken "Furnizime me shkalle 0%":

Ju sqarojme se shuma e te ardhurave prej 72,453,924 leke, e raportuar ne rubriken "Furnizime me shkalle 0%" perfaqeson vleren e sherbimeve qe shoqeria ka kryer per punimet ne Hidrocentralin e Banjes, per shoqerine "Limak" shoqeri nenkontraktore e "Devoll Hydropower", e cila ka te drejte te emeroje nenkontraktore te nivelit te 2-te (Isobar Construction), nga ku lind e drejta per te pergatitur fatura te cilat do te jene me TVSH 0% dhe do te pasqyrohen ne rubriken "Furnizime me shkalle 0%" me shenimin perkates "Sipas regjimit specifik të TVSH-së sipas ligjit Nr. 105/2013 date 28.03.2013".

13. Lenda e pare dhe Materiale te konsumueshme

Shuma e materialeve te konsumuara per vitin 2017 eshte 62,352,390 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Blerje materiale	43,492,480	51,873,037
2	Ndryshim gjendje	4,782,042	(7,887,167)
	Shuma e mat. Te konsumuara	<u>48,274,522</u>	<u>43,985,870</u>
	Te tjera shpenzime		
1	Karburant	14,057,911	11,908,233
2	Shpenzime te tjera	19,957	267,661
3	Sherbime nga te tretet	-	339,100
	Shuma e shpenzimeve te tjera	<u>14,077,868</u>	<u>12,514,994</u>
	Totali	<u>62,352,390</u>	<u>56,500,864</u>

14. Shpenzime te personelit

Shpenzimet per personelin paraqiten ne shumen 17,580,091 leke si me poshte:

Nr	Kosto e Punes	Viti 2017	Viti 2016
1	Shpenzime per paga	15,065,877	11,652,612
2	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	2,514,214	1,940,648
	Shuma	<u>17,580,091</u>	<u>13,593,260</u>

15. Shpenzime Konsumi dhe Amortizimi

Jane llogaritur shpenzimet per amortizimin e asetave sipas normave ligjore ne fuqi ne shumen 4,676,164 leke.

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Amortizimi I aktiveve	4,676,164	2,340,421
	Shuma	<u>4,676,164</u>	<u>2,340,421</u>

16. Shpenzime te tjera shfrytezimi

Ne kete ze jane ne shumen 9,891,045 leke, te perfshira si ne tabelen e meposhtme:

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Sherbim kontabel e auditimi, ligjor	614,502	416,533
2	Sigurime mjetesht	283,237	321,149
3	Blerje hidrosanitare	-	250,915

4	Materiale ndihmese, veshje pune	6,283,401	8,462,613
5	Kancelari	8,295	1,955
6	Qera	579,600	579,600
7	Taksa automjeti	-	74,663
8	Shpenzime telefonike	213,841	159,495
9	Transport per blerje	-	137,330
10	Sherbime bankare	19,836	81,803
11	Taksa vendore	67,000	67,000
12	Shpenzime dieta per personelin	-	4,950,000
13	Komision per qera financiare	-	47,317
14	Riparime mjetesh	1,817,833	-
15	Sherbim parkimi	3,500	-
	Shuma	<u>9,891,045</u>	<u>15,550,373</u>

Kuadrimi I blerjeve me shpenzimet e paraqitura ne bilanc

Ne tabelen e meposhtme paraqitet kuadrimi I blerjeve te pasqyruara ne FDP mujore me shpenzimet e perfshira ne pasqyrat financiare per vitin 2017.

Nr	Sipas FDP	Shuma ne leke
1	Blerje te perjashtuara	9,601,125
2	Blerje investimi pa tvsh	2,069,469
3	Blerje nga furnitore vendas	60,417,761
4	Blerje te investimit brenda vendit me tvsh 20 %	889,037
	Totali I blerjeve	<u>72,977,392</u>
Nr	Sipas bilancit	
1	Blerje materialesh	43,492,480
2	<i>korrigjohet me Ndryshimin e gjendjes</i>	4,782,042
3	Te tjera Shpenzime	14,077,868
3	Shpenzime te tjera shfrytezimi	9,891,045
4	Blerje AQT	2,958,507
5	Shpenzime per interesa (me fature)	268,148
	Shuma	<u>75,470,090</u>
	Diferenca	2,492,698
Nr	Korrigjohet me shpenzimet pa fature	
1	Taksa lokale	(67,000)
2	Sherbime bankare	(19,836)
3	Rimarrje shpenzime te shtyra 2016	(2,302,613)
4	Kalim shpenzime te shtyra 2017	3,980,788
5	Qera financiare	698,002
	Diference FDP-Bilanc	<u>0</u>

17. Te ardhura te tjera

Paraqiten te ardhura ne shumen 33,550 leke, te perfituara nga sistemi i tatim fitimit, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Te ardhura te tjera	33,550	5,833,951
	Totali I te ardhurave	<u>33,550</u>	<u>5,833,951</u>

18. Shpenzime Financiare

Paraqiten shpenzime ne shumen 696,907 leke per vitin 2017, te detajuara si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Gjoha e penalitete	(596,781)	(15,967)
2	Shpenzime per interesa Leasing	(268,148)	(102,791)
3	Fitime nga kursi I kembimit	168,022	-
	Totali	<u>(696,907)</u>	<u>(118,758)</u>

19. Llogaritja e rezultatit tatimor

Ne tabelen me poshte paraqitet llogaritja e rezultatit tatimor per vitin 2017. Shoqeria per vitin ushtrimor 2017 paraqitet me nje fitim neto prej 8,615,508 leke.

Nr	EMERTIMI	VITI 2017	VITI 2016
1	Te ardhura nga aktiviteti	105,404,254	91,905,751
2	Te ardhura nga shperblim demi	-	5,833,951
3	Te ardhura nga kembimet valutore	-	4,037,962
	Totali I te ardhurave	<u>105,404,254</u>	<u>101,777,664</u>
4	Shpenzime	(95,163,048)	(88,174,972)
5	Rezultati i ushtrimit	10,241,206	13,602,692
6	Shpenzime te pazbritshme	<u>596,781</u>	<u>118,758</u>
7	Rezultati tatimor	<u>10,837,987</u>	<u>13,721,450</u>
8	Tatim fitimi	(1,625,698)	(2,058,218)
	Fitimi neto	<u>8,615,508</u>	<u>11,544,474</u>

Shpenzimet e pazbritshme ne shumen 596,781 leke jane shpenzime te detajuara si me poshte :

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Gjoha e penalitete	596,781	15,967
3	Shpenzime per interesa Leasing	-	102,791
	Totali	<u>596,781</u>	<u>118,758</u>

20. Angazhime dhe pasiguri**Çeshtje gjyqesore**

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2017 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, qe mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

21. Ngjarje pas datës së Bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Administratori

Alban Tarelli



Hartuesi i pasqyrave

Anita Pulaj